



Bošnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova

Pasqyrat Financiare Vjetoredhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar2014 - 31 Dhjetor 2014

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-11

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Bošnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit politik Bošnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “BSDAK” apo “SP”), te përbëra nga pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2014, pasqyra e te hyrave dhe shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 6-11.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit Bošnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinioneve

- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që Subjekti Politik nuk e ka bartë suficitin nga vitet e mëparshme në Pasqyrën e Pozicionit Financiare nga pasqyra e te hyrave dhe shpenzimeve.
- Ashtu siç është prezantuar në shënimin 2, Donacionet dhe kontributet në të holla, SP ka deklaruar donacione në vlerë 25,000.00 EUR për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2014, Subjekti Politik ka pranuar donacione përmes arke në vlerë 25,000.00 EUR në kundërshtim me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 4 Burimet financiare dhe materiale, paragrafi 4. Për më tepër, SP ka pranuar donacion në para të gatshme nga personi fizik në shumat mbi 1000,00 euro brenda një dite e cila është shkelje e Ligjit Nr. 03/L-196 , neni 25 pika 1 e këtij ligji.
- Siç paraqitet në shënimin 3 të pasqyrave financiare, Subjekti Politik ka deklaruar në Shpenzime në vlerë prej totale prej 42,757.72 euro për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014, ne mungese të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të konstatojmë nëse shpenzimet e deklaruara janë të sakte
- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që SP nuk ka prezantuar shënimet krahasuese nga viti i kaluar përkundër faktit që SP ka zhvilluar aktivitet gjatë këtij viti.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një

siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Fatmir Mehmeti
Auditor Ligjor
29Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

	Shënime	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma ne Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma ne Euro
Pasuritë afatgjata			
Toka, objektet dhe pajisjet		0.00	0.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		-	-
Pasuritë afatshkurtra		0.00	0.00
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet		0.00	0.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë			
Pasuritë tjera afatshkurtra		-	-
Total pasuritë afatshkurtra		-	-
Total pasuritë		0.00	0.00
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		0.00	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		0.00	0.00
Total Ekuiteti		-	-
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		-	-
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera		0.00	0.00
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		-	-
Gjithsej detyrimet		-	-
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		0.00	0.00

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti qe përfundon me 31.12.2014	Viti qe përfundon me 31.12.2013
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		17,697.73	
Të hyrat nga anëtarësia		0.00	
Donacionet dhe kontributet në të holla	2	25,500.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime		0.00	
Të hyrat e fushatës		0.00	
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		0.00	
Të hyrat tjera		-	
Gjithsej të hyrat për vitin		43,197.73	-
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	3	0.00	
Shpenzimet e transportit	3	15,550.00	
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	3	6,459.37	
Shpenzimet e fushatës	3	13,957.45	
Blerja e mallrave	3	1,528.47	
Shpenzimet e përgjithshme	3	2,574.93	
Shpenzimet e ndryshme	3	2,687.50	
Gjithsej shpenzimet për vitin		42,757.72	-
Suficiti (+) ose deficit (-) për vitin		440.01	-

1. Informata te përgjithshme

Bošnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullores nr. 01/2008 të KQZ-së mbi regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

Kjo parti politike është regjistruar më 21/08/2000 me numrin regjistrues : 103-0800

Statusi i tanishëm dhe i ardhshëm i regjistrimit të kësaj partie politike varet nga veprimi në përputhje me kërkesat e vazhdueshme të Rregulles së KQZ-së nr. 01/2008

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën RBKO.

Shënimi 2: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Hilmo Kandic	Bulevar Narodni Heroja 10		10.05.2014	8,000.00		8,000.00
Gzim Spahiju	Juzna Mitrovica		12.05.2014	7,000.00		7,000.00
Hatija Kandic	Bulevar Narodni Heroja 10		02.06.2014	5,000.00		5,000.00
Hakija Kandic	Imzot Nik Prela 9		05.06.2014	5,500.00		5,500.00
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				25,000.00	0.00	25,000.00

Shënimi 3: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompenzimet			
Pagat dhe kompenzimet, neto			0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit			0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit			0.00
Tatimet në të ardhura personale			0.00

Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	11,222.35	11,222.35	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	1,158.11	1,158.11	0.00
Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave	674.85	674.85	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	548.13	548.13	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	13,603.44	13,603.44	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			0.00
Ushqimi	4,378.25	4,378.25	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	548.00	548.00	0.00
Radio dhe spotet televizive	-	-	0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	3,157.46	3,157.46	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	-	-	0.00
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	8,083.71	8,083.71	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	15,555.00	15,555.00	0.00

Gjithsej shpenzimet e fushatës	15,555.00	15,555.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	879.54	879.54	0.00
Pajisjet të vogla	657.11	657.11	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	1,536.65	1,536.65	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës			0.00
Telefoni, interneti dhe posta	1,759.25	1,759.25	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	756.15	756.15	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	-		
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	-		
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	2,515.40	2,515.40	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	857.52	857.52	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	606.00	606.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	1,463.52	1,463.52	0.00
Gjithsej shpenzimet	42,757.72	42,757.72	0.00